

TË NDERUAR LEXUES,

Broshurën të cilën e keni në dorë e përgatitëm me qëllim q t'u informojmë për seriozitetin e dhunës në familje.

Fenomeni i dhunës në familje e ndjek njeriun, përkatësisht njerëzimin gjatë gjithë ekzistencës së vet shekullore. Ajo nuk mund të lidhet vetëm me një komb, kulturë, racë, fe apo karakteristikë tjetër shoqërore.

Vetëm para dhjetë vjetësh, dhuna familjare në vendin tonë konsiderohej si punë private e cila ndodh prapa dyerve të mbylura të shtëpisë. Askush nuk interesohej, dhe as nuk merrej me zgjidhjen e problemeve të të rrahurave, të poshtëruarave, pa të drejte fjale dhe zgjedhjeje, të mijëra grave të cilat me kalimin e pragut familjar hapërojnë në atarin e ferrit – në rrethin e dhunës familjare.

Në faqet që vijojnë keni mundësinë të niheni me të dhënat themelore të studimit „Jetë në hije” të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e numrit të erët të dhunës familjare mbi gratë dhe karakteristikat e tij. Këto të dhëna janë marrë në bazë të anketimit të kryer mbi 1432 të anketuara – persona në moshë madhore të seksit femëror, me përfshirjen e 21 lagjeve urbane dhe 27 lagjeve rurale. Njëkohësisht, janë paraqitur sisteme për mbrojtje, përkatësisht mënyrat dhe format për zgjidhjen e këtij lloji dhune në vendin tonë.

Dhe në fund ju janë prezantuar rastet e paraqitura të dhunës familjare në institucionet të cilat kanë mandat ligjor që të veprojnë ndaj dhunës familjare.

Sinqerisht shpresojmë se publikimi do të kontribuojë që opinioni të njihet me këtë të keqe shoqërore dhe se e njëjta do të përbëjë nxitje për njohje dhe paraqitje të këtij lloji dhune, si dhe për dhënien e ndihmës pa rezervë për ata të cilët e kanë më të nevojshme – viktimave të dhunës familjare.



Shoqata për emancipim, solidaritet dhe barazi të grave në RM-ESE




DHUNA FAMILJARE NË SHETETIN TONË

– NUMRI I ERËT

Tri llojet e dhunës familjare mbi gratë janë të përhapura gjerësisht në hapësirat tona. Çdo e dyta grua në republikën e Maqedonisë është viktimë e dhunës psikike. Çdo e gjashta grua ka pësuar dhunë fizike, kurse çdo e dhjeta e ka përjetuar dhunën seksuale.

Dhuna e paraqitur në vitin 2006



Masa më e madhe e dhunës së paraqitur është dhuna psikologjike me 56,4%. Më pak, më saktë 17,7% e grave kanë paraqitur se janë viktimat e dhunës fizike, kurse 10,6% kanë paraqitur se u është cekur integriteti seksual.


DHUNA PSIKOLOGJIKE

Çdo e dyta grua është viktimë e dhunës psikologjike

Dhuna psikologjike mbi gruan, i përfshin kontrollin e lëvizjes dhe kontaktet e gruas, xhelozinë dhe pronësinë, si dhe sjelljet të cilat shkaktojnë brenga emocionale apo psikike dhe vuajtje të gruas.

Çdo e dyta grua është viktimë e ndonjëres prej këtyre nënlojesh të dhunës. Forma më e shpeshtë e dhunës psikologjike në shtetin tonë është kontrolli i lëvizjes dhe kontaktet që i realizon gruaja. Si viktimë e kësaj forme të dhunës psikologjike shfaqet çdo e treta grua (36,5%). Forma e dytë sipas përfaqësimit të dhunës psikike është ajo nëpërmjet të cilës del në pah dominimi i burrit dhe pozita inefiore e gruas në familje, përkatësisht „fjala e tij (burrit) duhet të jetë e fundit“ (28%). Çdo e katërta grua (25,6%) ka paraqitur se se bashkëshorti/partneri sillet keq me atë apo përsëri është shumë xheloz (23,5%).





Që në fillim ai e shfaqti xhelozinë e vet. Megjithatë, mua jo vetëm që nuk më pengonte ajo por edhe më impononte sepse mendoja se është shfaqje e dashurisë së tij për mua. Që në ditët e para të martesës ma bëri të ditur se ka alergji prej çdo lloj kozmetike, se një gruajë të ndershme dhe të martuar nuk i shkon të bëjë makijazh si ndonjë aktore ose Perëndia më ndjeftë si prostitutë. Shumë e dashuruar nuk thashë asgjë dhe e fsheha atë deklaratë të tij, domethënë e bërë hapin e parë të gabuar drejt shpëtimit të fatit tonë. Nuk duhej shumë kohë që ai t'i merrte të gjithë liritë dhe të drejta mbi mua, mbi mendimet e mia, mbi gjendjen time shpirtërore, mbi sjelljen time.

Nuk donte të dilte si më parë, i pengonin bisedimet telefonike me prindërit, të afërmit, shoqet e mia. Për të gjithë[ata kishte nga një fjalë fyese, ndërsa më shumë për mua. Në fillim isha, dele, pastaj dhi, budallaqe, majmun – shumë shpejt përpornonte evoluimi im, por assesi të arrija atë që në të vërtetë isha. Gjithçka që do të thosha nuk bënte dhe çdo gjë që bëja nuk ishte e mirë. Nga dita në ditë ai ishte personifikim i së përkryerës, kurse unë personifikim i budallallëkut, paaftësisë.

Dhe me të vërtetë fillova të jem e tillë. Asnjëherë nuk më goditi. Ai vetëm vidhte pjesë pas pjesë prej meje. Pjesë të cilat tani dua, në mënyrë[të dëshpëruar dua t'i kthej, t'i vendos dhe të vazhdoj të jetoj normal isht.

DHUNA FIZIKE

Çdo e pesta grua është viktimë e dhunës fizike

Dhuna fizike si forma më e dukshme e dhunës familjare, nëkupton përdorimin e dhunës fizike prej dhunuesit mbi viktimën duke përfshirë edhe kërcënimet për përdorim të dhunës.

Kjo formë dhuneje në shtetin tonë më shpesh shprehet nëpërmjet shuplakave (87,5%), kërcënimeve për përdorim të dhunës fizike, tërheqje dhe shtyrje (63,9%). Por, dhuna fizike është e shprehur edhe nëpërmjet shumë formave të rënda si shkelmim, kafshim, përvilim etj.

Shpeshtësia e manifestimit të mëvetësishëm të dhunës fizike, e bën këtë dukuri më të vështirë dhe më të rrezikshme. Gratë viktimë në vendin tonë kanë qenë viktimë të dhunës fizike të shumëfishtë. Më shpesh, çdo e katërta grua, ka thënë se një deri në dy herë ka qenë e sulmuar fizikisht në suazat e familjes së saj. Pothuajse, çdo e pesta grua (18,9%) ka paraqitur dhunë fizikë mbi 20 herë.



Jeta më ka qenë ferr. Kur më rrihte me stap, kur me shkelma, kur me bokse, kur do të më zinte për floku, kur do të ma godiste kokën në murr, më duhej të bija në gjunjë që ta lusja, që të më lëshojë. Kështu kisha jetën afërsisht 15-16 vjet.

Dinte të shkatërronte banesën, të thyejë. Gjithë kohën jetonim nën presion dhe stres. Në moment dinte ta ndryshonte gjendjen shpirtërore. Vetëm të binte zilja e telefonit dhe ai ishte i shqetësuar.

Në gjunjë do të binte, të lutem kjo nuk do të përsëritet më. Por, vetëm një muaj, pas një muaji i njëjti avaz. I duroja të gjitha pasojat, të mos bëj turp, të mos thonë fëmijët se nëna na shkon nga një burrë në tjetër. Nuk e bëra atë. Prandaj mbeta me të. Jeta ime ishte si ferri. Filloi në 5 në mëngjes. U ngrit dhe e përzu fëmijën. Unë i thashë: Në qoftë se ikën fëmija im do të iki dhe unë. Do të iki dhe unë prej këndeje, dhe na shtëpinë dhe jeto. Kurse ai e mori thikën pa e parë, thikë e madhe kuzhine, e mori dhe e fshehu pas veti. Unë mendova se si çdo herë tjetër vetëm do të më godasë. Por, kur pashë se me thikë do të më godasë drejt e në zemër, u bëra anash dhe në vend që të më godiste në zemër më goditi në stomak. Filloi të më rridhte gjak, e mbylli derën dhe nuk më lëshonte që të më rridhte gjaku deri në vdekje. E kapi dhe fëmijën nga dora, e rrotullonte thikën që ta shponte edhe fëmijën. Përpjekje për vrasje për të dy. Unë nuk e di se si mund të shëtisë në rrugë një vrasës i tillë, vetëm këtë nuk e kam të qartë ...



DHUNA SEKSUALE

Çdo e dhjeta grua është viktimë e dhunës seksuale.

Dhuna seksuale nënkupton kryerje të marrëdhënieve seksuale apo ndonjë lloj tjetër vepërimitarie seksuale me detyrim. Forma dominante e dhunës seksuale është marrëdhënia seksuale pamëshirë. Atë e kanë paraqitur 85.5% e grave-viktima. Marrëdhënia seksuale poshtëruese është paraqitur në 6.6%, kurse përdhunimi në 3.9% të rasteve. Më pak të përfaqësuara janë detyrimi dhe shikimi me dhunë i filmave pornografikë. Edhe pse këto format e fundit të dhunës familjare janë më pak të përfaqësuara (gjithsej 13,8%), ato në thelbin e vet përbëjnë shkelje të rënda të dinjitetit të gruas.

Gratë ende janë të papërgatitura që të flasin për dhunën seksuale, për çka flet edhe e dhëna se çdo e treta grua (32,6%) nuk i është përgjigjur pyetjes për shpeshësinë e kësaj lloji dhune. Shumica,



(3=27,8%) e grave kanë thënë se integriteti seksual - u është shkelur tre deri në dhjetë herë në suazat e familjes. Shumë ndikues është fakti, sipas të cilit, 13,2% e grave kanë paraqitur dhunë seksuale mbi 20 herë.

Na shqetëson niveli i ulët i paraqitjes së dhunës seksuale, sidomos kur dimë, se, 43% e viktimave të dhunës kanë deklaruar se pas dhunës fizike shpesh ka pasuar marrëdhënia seksuale, e cila gjithsesi nuk ka qenë me dëshirë. Kjo flet se gratë janë të ballafaquara njëkohësisht dhe me dhunën fizike dhe me dhunën seksuale, dhe se në realitet dhuna seksuale është mjaft më e përfaqësuar se ajo sa kanë paraqitur gratë (10,6%).



Fillonte me demek të kërkonte falje që na lë mënjanë mua dhe fëmijën, demek se do të ndryshojë, vetëm të duroj pak, apo do të nxehej dhe e gjitha kjo do të përfundonte me nuk ishte ajo bërje dashuri, por përdhunim. Pas asaj ndihesha mizorisht më tepër. Nuk mund të haja sa më duhej ushqim. Fillova të vjell prej nervozës. Takihardia u bënë të përditshme. Disa herë mu desh të shkoja tek mjeku dezhurn për shkak të problemeve me zemrën. Pas një nervozeje të tillë iu desh të kërkojë ndihmën e shpejtë sepse më ra të fikët. Gjithë kohën më mbante në krah, dhe kërkonte të falur dhe tha se nuk ka për të ndodhur kurrë më. Megjithatë punët u përsëritën pas disa ditësh.

Do të mërzitesha, e do t'i thosha se do ta lë, nuk mundem më. Mirë, do më shikonte se isha në fund, se thërrisja, se pija leksilium me vite, që nesër nuk do të flas asgjë, nuk do të bëj asgjë. Kjo zgjaste vetëm dy-tre ditë.

PASOJA TË DHUNËS FAMILJARE - INCIDENTI I FUNDIT

Lloje lëndimesh


Gjatë incidentit të fundit të dhunës familjare – 58% e grave viktime të dhunës familjare janë lënduar fizikisht.

Dhuna mbi gratë rezulton me lloje të ndryshme të lëndimeve fizike, prej nga më të lehtat deri te shumë të rëndat. Forma më e shpeshtë, apo më saktë, pasojë e dhunës fizike janë mavijosjet në trupin e gruas. Sipas shpeshtësisë, vijojnë prerjet dhe lëndimet prej goditjeve me thikë apo tjetër mjet. Marrë në përgjithësi gratë janë viktime dhe të formave më të rënda të dhunës fizike siç janë thyerjet etj.

Pavarësisht prej lëndimeve të cilat i kanë marrë gratë dhe nevojës për ndihmë mjekësore, ato nuk kanë kërkuar ndihmë, janë mjekuar vetë, nga frika prej dhunuesit apo turpit prej mjedisit rrethues për shkak të dhunës që durojnë. Vetëm 23,1% e viktimave të dhunës kanë kërkuar ndihmë mjekësore. Prej grave që kanë kërkuar ndihmë mjekësor, çdo e treta (34%) është mbajtur në mjekim spitalor.

Lëndimet e paraqitura janë manifestuar si vijon:

- ▶ Mavijosje 46,1%
- ▶ Prerje 14,2%
- ▶ Lëndime me thikë 11,2%
- ▶ Rënie të fikët 8,3%
- ▶ Thyerje 3,5%
- ▶ Lëndim të syrit 3,5%
- ▶ Thyerje dhëmbësh 2,5%
- ▶ Djegie 1,7%



Ndikimi i dhunës mbi viktimat

Viktimat me vështirësi e pranojnë jetën në kushte të dhunës. Frika, humbja e vetëbesimit, depresioni dhe pagjumësia janë pasojat më të shpeshta të sjelljes së dhunshme mbi gratë. Por, ka edhe pasoja të tjera të cilat janë relativisht më të përfaqësuar. Ato janë gjendje që ndikojnë mbi sigurinë e grave dhe krijojnë personalitet të pasigurt. Prej saj u ulen aftësitë për të reaguar dhe për të kundërshtuar dhunuesin. Në disa raste dhuna ka shkaktuar dhe sëmundje të caktuar psikike.

Ndikimi i dhunës

- ▶ Frikë 22,9%
- ▶ Humbje të vetëbesimit 16,7%
- ▶ Depresion 16%
- ▶ Prishje gjumi 14,2%
- ▶ Vështirësi psikike 12%
- ▶ Sëmundje psikike 10,2%
- ▶ Refuzim kontaktesh, izolim 8%

Ballafaqimi me dhunën

Ballafaqimi me dhunën, për një numër të caktuar grash nuk është i mundur pa ndihmën përkatëse e shprehur nëpërmjet marrjes së medikamenteve, pirjes së tepërme të duhanit dhe marrjes së tepërme të ushqimit. Ballafaqimin me dhunën, gratë e shprehin më shpesh nëpërmjet marrjes së medikamenteve, në shumicën e rasteve pa konsultim me mjekun. Mekanizmi më i rrallë për mbrojtje prej dhunës është marrja e tepërme e ushqimit.

Ndikimi i dhunës mbi aftësinë për punë të grave

Çdo e treta grua është ankuar për paaftësi për përqendrimi, si rezultat i dhunës që duron, kurse çdo e pesta grua për paaftësi për punë. Praktikisht, mbi dy të tretat e grave – viktimat dhuna ka ndikuar mbi aftësinë e tyre për punë. Ky është ndikues serioz i cili flet për rëndësinë e këtij lloji të sjelljes kriminale, sidomos për spektrin e pasojave që i lë mbi jetën dhe cilësinë e jetesës së gruas.


Çdo e katërta grua ka deklaruar se dhuna nuk i ka ndikuar në rënien e aftësisë së saj të punës.

Dhuna dhe fëmijët

Kur bëhet fjalë apo studiohet dhuna mbi gratë, sidomos kur është në pyetje familja, nuk mund të mos përmendet apo t'u kushtohet vëmendje fëmijëve. Kjo sepse ata janë të lidhur ngushtë, sepse gjatë ekzistimit të dhunës në familje, pa përjashtime, fëmijët janë viktime – të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë.

Në shtetin tonë më tepër se gjysma e grave-viktima (58,3%) deklaruan se fëmijët kanë qenë prezentë në dhunë. Prej tyre 17,9% kanë qenë rregullisht të pranishëm në dhunë 27,7% kanë qenë përkohësisht të pranishëm dhe rrallë të pranishëm kanë qenë 13,3 e fëmijëve të grave-viktima.

Çdo e pesta grua (20,7%) deklaroi se dhuna ka qenë e drejtuar edhe mbi fëmijët. Në këtë rast fëmijët janë viktime të drejtpërdrejta të dhunës. Është e madhe përqindja (11,5%) e grave që kanë refuzuar t'i japin përgjigje, që mund të merret si indikator, që fëmijët të kenë qenë viktime të dhunës familjare në një masë më të madhe.



PRANIMI I VLERAVE ME PËRMBAJTJE PATRIARKALE

– SI SHKAK I SHFAQJES DHE MBIJETESËS SË DHUNËS FAMILJARE

Vlerat tradicionale, përkatësisht pranimi i lartë i vlerave patriarkale në martesë janë shkaku kryesor i dukurisë së dhunës familjare në vendin tonë. Shkalla e pranimit i këtyre normave dhe vlerave është e lartë.

Kështu që norma “gruaja e mirë e pranon mendimin e burrit edhe atëherë kur nuk është dakord me të” është e pranuar prej 57,2% dhe mund të konsiderohet si normë e sjelljes. Surpriza më e madhe dhe njëkohësisht dhe më dërmuese është dëshmia se çdo e treta grua (28,3%) pranon, përkatësisht e miraton dhunën mbi gratë - në raste të caktuara.

Prindërive të tij disa herë u jam ankuar, por nuk treguan asnjëlloj kuptimi për mua, për mundimet e mia, për jetën time.

- Burrë është thonë. ka të drejtë dhe të pijë dhe të godasë.

Prindërit e mi gjithashtu.

- E deshe e more thonë ata. Dhe nuk je vetëm ti dhe të tjerë në fshat e kanë atë problem, dhe unë i ankohen askujt, dhe as bëjnë tragjedi prej saj...



Bashkëshortja e mirë e respekton mendimin e bashkëshortit të vet, madje edhe kur nuk është dakord me të

Kjo vlerë është e më e pranueshme për gratë e shtetit tonë, në krahasim me të gjitha vlerat e tjera. Çdo e dyta grua bie dakord me të – 57,7%.

Është e rëndësishme burri t'i tregojë bashkëshortes së vet se cili është kryesori në familje.

Kjo është një prej vlerave familjare tradicionale, sipas të cilës burri është i vendosur në kreun e familjes (e pranuar prej 43,8%). Më konkretisht, është e rëndësishme burri t'i tregojë gruas se kush është kreu i familjes. Pranimi i kësaj vlere, për gruan automatikisht do të thotë pranim i pozitës inferiore në familje, përkatësisht pranim i modelit patriarkal të rregullimit të marrëdhënieve familjare, ku dominon burri.

Detyrë e gruas është të bëjë dashuri me bashkëshortin e vet madje edhe kur nuk do

Kjo vlerë i rregullon marrëdhëniet midis partnerëve në sferën seksuale, me pranim prej 29,8%. Dhe tek ajo vjen në pah pozicioni dominues i burrit dhe pozita nënrenditëse e gruas. Pozita nënrenditëse e gruas në sferën seksuale është më pak e pranueshme për më të rinjtë, kurse më shumë e pranueshme për të anketuara më të moshuara.

A ka burri shkak të mirë për ta goditur gruan

Gratë e arsyetojnë dhunën fizike prej burrit, me pranim prej (28,3%). Si shkaqe të cilat e arsyetojnë këtë sjellje të burrit më shpesh janë dhënë, i pakënaqur prej punëve të shtëpisë, ajo nuk e dëgjon, dyshim për tradhti dhe në qoftë se ajo e ka tradhtuar.




SISTEME PËR MBROJTJE

Në Republikën e Maqedonisë dhuna familjare është e përkufizuar në mënyrën që vijon:

Me dhunë familjare kuptohet keqtrajtimi, ofendimi i rëndë, rrezikimi i sigurisë, lëndimi trupor, dhunë fizike, apo psikike apo seksuale prej së cilës shkaktohet ndjenjë pasigurie, rreziku apo frike, ndaj shokut martesor, prindërve ose fëmijëve apo edhe personave të tjerë të cilët jetojnë në bashkësi martesore apo jashtë martesore apo amvisëri të përbashkët, si dhe prej bashkëshortit të mëparshëm apo personave me të cilët kanë fëmijë të përbashkët apo gjenden në marrëdhënie të afërme personale.

Me vetë përkufizimin e termit dhunë familjare lëshohet qëndrimi që kishte republika e Maqedonisë para vendosjes së Kodit Penal, sipas të cilit dhuna familjare është problem i familjes. Kjo do të thotë se dhuna familjare përbën problem shtetëror dhe shteti është ai që duhet t'i ndërmarë të gjitha masat dhe parametrat për ballafaqim të sukseshëm me problemin e dhunës familjare

Stojan Mihov, gjykatës, film dokumentar „Jetë në hije” , ESE, 2007



Regullimi i dhunës familjare në legjislativën pozitive e vendos Republikën e Maqedonisë në rradhën e shteteve e cila, përkrah sigurimit të detyrueshëm të sigurisë dhe mbrojtjes së nevojshme të viktimës së dhunës familjare, vendosi dhe mbrojtje juridike tërësore të viktimave në rastet e tilla. Shteti e sanksionon sjelljen dhunuese të dhunuesit dhe shqipton masa të përkohshme për mbrojtje prej dhunës, nëpërmjet ndalimit dhe caktimit të një sjelljeje të caktuar për dhunuesin.

Masa për mbrojtje

Sigurimi i mbrojtjes dhe sigurisë së viktimës prej dhunës së ardhshme, përkatësisht ndihmës për tejkalimin e pasojave të dhunës së përjetuar, si dhe krijim të kushteve për integrimin e saj në mjedisin social, janë kushtet themelore të cilat duhet të plotësohen gjatë marrjes së masave për mbrojtje.

Masa për mbrojtje ndërmerren prej Qendrave për Punë Sociale dhe organizatave qytetare të cilat sigurojnë shërbime të drejtpërdrejta për viktimat e dhunës familjare:

- ▶ siguron strehim të nevojshëm për personin-viktimë të dhunës, i cili mund të zgjasë minimum 6 muaj, me mundësi për vazhdim për akoma 6 muaj.
- ▶ siguron mbrojtje shëndetësore përkatëse;
- ▶ siguron intervenim dhe trajnim përkatës psikik-social;
- ▶ i drejton në këshillimore;
- ▶ në qoftë se në familje ka fëmijë i cili është në shkollim të rregullt, ndihmon për vazhdimin e arsimit të rregullt;
- ▶ e lajmëron organin për ndjekje;
- ▶ jep çdo lloj ndihme dhe përfaqësimi juridik;
- ▶ ngre procedurë në gjykatën kompetente;
- ▶ sipas nevojës dorëzon kërkesë në gjykatë për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje dhe
- ▶ ndërmerr masa të tjera për të cilat do të vlerësojë se janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemit.

Sisteme juridike për mbrojtje

Në asnjë rast zgjidhjet ligjore të parapara në të dy sistemet juridike (juridik-qytetar dhe juridik-penal) për mbrojtje nuk duhet të zbatohen në dëm të njërit, përkatësisht tjetrit. Sipas përmbajtjes së vet dhe para së gjithash qëllimi për të cilin janë paraparë këto sisteme janë komplementare dhe vetëm në atë kuptim duhen zbatuar.

Sistemi juridik-penal për mbrojtje

Me ndryshimet e Kodit penal prej marsit të vitit 2004 është vendosur mbrojtja penale-juridike e viktimave të dhunës familjare. Me to për herë të parë është përcaktuar dhuna familjare, dhe e njëjta u bë lëndë e inkriminimit, nëpërmjet inkorporimit të zgjidhjeve përkatëse në veprat penale që ekzistojnë në këtë ligj.


Dhuna familjare nuk është paraparë si NJË vepër penale e mëvetësishme, por sanksionohet nëpërmjet inkriminimit të formave të mëvetësishme të saj nën veprat penale ekzistuese.

Me vepra penale kundër jetës dhe trupit sanksionohen: privimi nga jeta, prishja apo dëmtimi i integritetit trupor, shkaktimi i sëmundjeve trupore apo shpirtërore (lëndim trupor dhe lëndim trupor i rëndë). Këto janë format e inkriminuara të dhunës fizike.

Me vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut sanksionohen: detyrimi, privimi jo i ligjshëm prej lirisë dhe rrezikimi i sigurisë.

Me vepra penale kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual sanksionohen: përdhunimi, marrëdhëniet me person të pafuqishëm, sulm seksual mbi fëmijë dhe ndërmjetësimi për kryerje të prostitucionit.

Karakteristika kryesore e sistemit penal-juridik është politika dënuese më e rreptë në marrëdhënie me dhunën familjare. Ajo manifestohet në dënimet më të rrepta të përcaktuara për vepra penale që janë kryer gjatë kryerjes së dhunës familjare dhe ndjekjes së këtyre veprave penale sipas detyrës zyrtare. Në këtë mënyrë, në përputhje me përfaqësimin, natyrën dhe pasojat, dhuna familjare dallon prej llojeve të tjera të kriminalitetit.



Sistemi juridik-qtetar i mbrojtjes – masa të përkohshme për mbrojtje

Sistemi juridik-qtetar për mbrojtje bazohet në masat e parapara/masat e përkohshme për mbrojtje të parapara me reformat e legjislacionit familjar të vitit 2004.

Masat e përkohshme për mbrojtje duhet të jenë mekanizmi kryesor i cili do t'i mbrojë viktimat. Rëndësia e tyre qëndron në atë që t'i tregohet dhunuesit apo dhunuesve potencialë se ajo që kryejnë është e paligjshme dhe dënohet.

Suzana Vellkovska, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. film dokumentar “Jetë në hije”, ESE, 2007



Themelore është këto masa të përkohshme për mbrojtje të mundësojnë ndihmë të shpejtë dhe të drejtpërdrejtë të viktimës. Por, siç vihet re që më parë, zbatimi i tyre në shumicën e rasteve varet prej eskalimit, përkatësisht madhësisë dhe llojit të dhunës. Kështu, në qoftë se ekziston lëndim serioz apo një sërë incidentesh me një intensitet të zmadhuar, masat e përkohshme për mbrojtje dhe ndjekja penale së bashku mund të arrijnë rezultate më efikase.

Masat e përkohshme mund të jenë të dobishme sidomos në rastet kur viktimat do ta mbajë bashkësinë me dhunuesin dhe shpreson se vendimi gjyqësor për masën e përkohshme të shqiptuar do të kontribuojë që dhunuesi të mësojë se sjellja e tij është e palejueshme dhe ka nevojë ai të ndër marrë metoda jo të dhunshme të sjelljes.

Përmbajtja e llojeve të ndryshme të masave të përkohshme për mbrojtje mundëson kënaqjen e llojeve të ndryshme të nevojave për mbrojtje, pavarësisht se a bëhet fjalë për shqiptimin e tyre individual apo të përgjithshëm. Gjatë kësaj një pjesë e tyre kanë karakter ndalues (ndalojnë një sjellje të caktuar të dhunuesit), kurse të tjerat kanë karakter imperativ (urdhërojnë një sjellje të caktuar të dhunuesit).

Masa të përkohshme për mbrojtje të cilat mund të shqiptohen prej gjykatës janë:

- ▶ ndaloi të kërcënojë se do të kryejë dhunë familjare;
- ▶ ndaloi të keqtrajtojë, shqetësojë, telefonojë, kontaktojë apo në ndonjë mënyrë tjetër të komunikojë me ndonjë anëtar të familjes, direkt apo indirekt.
- ▶ ndalim të afrohet te vendbanimi, shkolla, vendi i punës apo vend të caktuar në të cilin rregullisht shkon ndonjë anëtar tjetër i familjes;
- ▶ caktoi largim prej shtëpisë pa marrë parasysh pronësinë, deri në marrjen e vendimit konkret prej gjykatës kompetente;
- ▶ ndaloi posedimin, mbajtjen e armëve të zjarrit apo tjetër, dhe njëta do t'i merret;
- ▶ e obligon t'i kthejë të gjitha objektet të cilat janë të nevojshme për plotësimin e nevojave të përditshme të familjes;
- ▶ shqiptoi alimentacionin e detyruar të familjes;
- ▶ urdhëroi i gjykuari të shkojë në këshillimore përkatëse;
- ▶ urdhëroi mjekim të detyruar, në qoftë se është përdorues i alkoolit dhe substancave të tjera psikotrope, apo ka ndonjë sëmundje;
- ▶ e obligon t'i kompensojë shpenzimet mjekësore apo të tjera që kanë ndodhur prej dhunës familjare dhe
- ▶ shqiptoi cilën do masë tjetër të cilën gjykata e konsideron si të domosdoshme që të sigurohet siguria dhe gjendja e mirë e anëtarëve të tjerë të familjes.



PËRGGJIGJJA INSTITUCIONALE

Paraqitja e dhunës familjare

Qendrat për punë sociale

Qendra për Mbrojtje Sociale ka rol kryesor në mbrojtjen e viktimave të dhunës familjare, nëpërmjet ndërmarrjes së masave për mbrojtje dhe propozim të masave të përkohshme për mbrojtje të cilat shqiptohen prej gjykatës.

Në periudhën prej qershorit 2005 – qershor 2006 në qendrat për punë sociale janë paraqitur gjithsej 839 raste të dhunës familjare. Mesatarisht, çdo muaj, në qendrat për punë sociale paraqiten 70 raste të dhunës familjare.

Si viktimat e dhunës familjare dominojnë gratë, gjatë kësaj janë evidentuar në 93,11% dhe burrat me 6,89% të rasteve të paraqitura. Dhunën më shpesh e kanë paraqitur vetë viktimat, dhe kjo në më shumë se gjysmën e rasteve të paraqitura (487).

Policia

Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht organet e punëve të brendshme gjatë vitit 2005 kanë evidentuar 215 vepra penale për të cilat janë ngritur fletëdenoncime penale, 1202 shkele dhe 3750 ankesa për dhunë familjare. Gjatë vitit 2006, në lidhje me dhunën familjare janë rregjistruar 258 vepra penale, 965 shkelje, kurse është vepruar edhe për 2650 ankesa.

Për seriozitetin dhe intensitetin të cilët dhuna familjare i ka para së gjithash mbi gratë, flet dhe e dhëna e policisë, sipas së cilës, dhuna familjare e ushtruar mbi femrat është e përfaqësuar në nivel të lartë në kriminalitetin e përgjithshëm të ushtruar mbi femrat dhe kjo 61% në vitin 2005, 63% në vitin 2006 dhe 52% për gjysmën e parë të viti 2007¹. Nga ana tjetër përsëri, dhuna familjare e ushtruar mbi femrat në kriminalitetin e përgjithshëm të rregjistruar është e përfaqësuar me 18% në vitin 2005, 19% në vitin 2006 dhe 26% në gjysmën e parë të vitit 2007¹. Shkalla e tillë e përfaqësimit të dhunës familjare në kriminalitetin e përgjithshëm është më e lartë në qoftë se merret parasysh se përqindjet e dhëna kanë të bëjnë me lëndët e evidentuara në të cilat si viktimë shfaqet gruaja.

¹ Burrim: Informacion prej Ministrisë së Punëve të Brendshme i dorëzuar në ESE për nevojat e përgatitjes së studimit "Dhuna familjare dhe lidhja e saj me armët e vogla dhe të lehta", prej Organizatës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara UNDP, përkatësisht Agjencisë për kontroll dhe zvogëlim të armëve të lehta dhe të vogla në Evropën Juglindore.

Prokurori themelore publike

Prokuroritë themelore publike kanë evidentuar 276 fletëdenoncime penale që janë dorëzuar në to. Prej tyre, prokuroria në gjykatë ka dorëzuar 238 akte prokurorie. Kjo do të thotë se prej fletëdenoncimeve penale PThP-ja proceduron 86% të tyre në gjykatë.

Procedurat penale para gjykatave

Gjykatat themelore kanë vepruar gjithsej në 311 aktakuza, prej të cilave 257 kanë të bëjnë me vepra penale kundër jetës dhe trupit (dhunë fizike), 20 për vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut (dhunë psikike) dhe 14 në raport me vepra penale kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual (dhunë seksuale).

Masa të përkohshme për mbrojtje

Prej (183) rasteve të përcaktuara në të cilat ka pasur nevojë për shqiptimin e masave të përkohshme, Qendra në gjykatë ka dorëzuar 58 kërkesa, përkatësisht çdo të tretës viktimë i është mundësuar mbrojtja e këtij lloji.

Gjatë një viti, në gjykatat në Maqedoni janë dorëzuar 41 kërkesa për shqiptimin e masave të përkohshme.

Dukshëm më i vogël është numri i masave të shqiptuara prej gjykatës, pas shqyrtimit të kërkesave, Domethënë, prej gjithsej 105 masave të propozuara janë shqiptuar 80 apo 76